

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: BEK FLUIDS LLC me adresë në FUSHE KOSOVE Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	17.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **16.06.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BEK FLUIDS LLC** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026**, me Numër të prokurimit: **623-25-3824-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-035-1-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BEK FLUIDS LLC** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026**, me Numër të prokurimit: **623-25-3824-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-035-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **11.06.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-25-3824-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-035-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **BEK FLUIDS LLC** me adresë në **Fushë Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026**, me Numër të prokurimit: **623-25-3824-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-035-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **11.06.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **16.06.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Sqarimet janë si në vijim:

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 17.11 thotë: *Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmimin për njësi me TVSH me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme.*

Oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme, pasi që te Përshkrimi i Çmimeve keni ofruar tek Çmim për njësi më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 3: *Operatorët ekonomik bashkë me ofertë duhen të dorëzojnë mostrat për një (1) thasë pelet sipas Përshkrimit të Çmimeve, në pajtueshmëri me specifikat e materialit në këtë Dosje të Tenderit. Mostrat do të dorëzohen në Zyrën e Prokurimit, 60 minuta para hapjes së ofertave, me këtë rast do të veprohet komfor Nenit 37 i RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK, Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i*

a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe

b. shënohen nga një kod

Dëshmia 3: *Mostrat e kërkuara tek specifikat teknike të mbyllura në një paketim dalluese të Operatorit Ekonomik*

Sqarimet janë si në vijim:

Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk janë në përputhje me Specifikat sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Dosjes së tenderit, për këto arsyeje:

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

SASIA	SIPAS PËRSHKRIMIT TË ÇMIMEVE
Paketimi	Në thasë plastike sipas standardit ENplus A1 dhe A2 me peshë ≤30 kg
Përbërja	Peleti të jetë 70 % dru ahu dhe 30% pishë Dorëzuar nga ana juaj: 100 % Dru
Lagështia	≤10 %
Dimensionet	diametri Ø 6 mm, gjatësia 31.5 mm ≤ L ≤ 40 mm dhe dendësia >600 kg/m³
Mbetja e pluhurit	≤2% Dorëzuar nga ana juaj: Nuk është e cekur: Mbetja e pluhurit ≤2%
Vlera më e ulët kalorike	≥4.6 kwh/kg
Gazrat e liruar	emitim neutral i CO ₂
Peleti duhet të jetë sipas standardit	ISO 17225-2 Dorëzuar nga ana juaj: Nuk ceket (mungon) në ambalazhin e shtypur ISO 17225-2
Mbetja e hirit	në 815°C të jetë 0,5% ≤ 1,5%
Të dhëna tjera	Karakteristikat e Peletit duhet të jenë të shtypura në ambalazh dhe të jenë të dukshme mirë

Për këtë çështje ka edhe **Vendim nga OSHP: 2024/0285;**

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Mostrat e dorëzuara nga na juaj:



Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

NENI -1 Qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik është shfrytëzimi i fondeve publike në mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahovecit, me eliminimin tonë nga ky aktiviteti i prokurimit ka bërë shkelje të nenit 1 “Qëllimi” të LPP-se sepse nuk ka vlerësuar drejtë pasi që tabela e përshkrimit të çmimeve kur të shkarkohet nga sistemi i ka vet 3 decimale pas presjes dhjetore dhe në nuk kemi të drejtë të nderhyjme në tabelat e çmimeve edhe pse çmimi jonë nuk ndryshon si këne me dy decimale si këne me tri decimale nuk ndryshon vlera e ofertës dhe çmimi i jonë ka qenë 228.49 prandaj sipas të gjitha interpretimeve edhe nëse ka më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Prandaj AK ka bërë shkelje sepse vet tabela e juaj ka qenë me 3 shifra pas presjes dhjetore dhe çmimi jonë nuk ka ndryshuar asnjë përmbajtje të ofertës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, **është i pabazuar**

Pas Shqyrtimit të ankesës dhe analizimit të ofertës tuaj, konstatojmë se ju OE **tek çmimi për njësi** keni dhënë çmime me më shumë se dy shifra pas presjes dhjetore dhe këtë Informatë e keni pasur tek formulari **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, dhe kjo bie ndesh me Nenin 17.11 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Sipas nenit 17.11 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, **e vetmja mundësi kur lejohet ofrimi i çmimit me më shumë se dy shifra pas presjes dhjetore është atëherë kur një gjë e tillë decidivisht ceket në dosje të tenderit.**

Në rast konkret në si AK nuk kemi cekur në dosje të tenderit se lejohet ofrimi i çmimit me më shumë se dy shifra pas presjes dhjetore, dhe **përgjegjësia e llogaritjes së formulave në Excel është e përgjegjësi e Operatorit Ekonomik ofertues.**

Nenit 17.11 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ndër të tjera thotë:

Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t'a përcaktoj në dosjen e tenderit.

Për këtë çështje ka edhe **Vendim nga OSHP: 273/20;**

Andaj Pretendimi juaj në këtë pikë **është i pabazuara**

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike: Është shkelur ky Nene për arsye se është shpallur fitues kompania e cila ka oferten me cmime shumë më të larta dhe jashtë prashikimit të Kontrates dhe cmimi i OE Fitues është shumë më i lartë se cmimi i tregut, Cmimi i Tregut është nga 190 Euro deri 220 Euro toni ndërsa OE Fitues cmimin e ka 275 euro Toni.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të këtij neni sepse ka shpallur fitues OE i cili ka ofertën më të shtrejtën dhe jashtë prashikimit të vlerës së kontratës dhe gjithashtu ka shpërblye OE me cmimin shumë më të shtrejt se cmimi i tregut dhe kështu lindin dyshime për bashkpunim dhe dakordim ndërmjet OE dhe AK-së.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Rahovecit, me eliminimin e kompanisë tona nga ky aktiviteti i prokurimit ka bërë shkelje të nenit 7 “Barazia në trajtim dhe jo-diskriminim” të LPP-së sepse ka diskriminuar kompaninë tona pasi që ne kemi ofruar Cmimin më të lirë, ka vendosur që të shpallë fitues Kompaninë NPT HARIS e cila nuk i plotëson kërkesat sipas Dosjes së Tenderit :SEPSE KA OFERETN ME CMIMIN ME TE SHTREJTE DHE JASHT PARASHIKIMI TE KONTRATES DHE GJITHEASHTU KA CMIMIN PER TON PER PELET SHUME ME SHTREJT SE SA ESHT CMIMI I TREGUT.

Në përputhje me nenin 59 “Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve” Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe

në dosjen e tenderit.

Komuna e Rahovecit ka bërë shkelje të këtij neni sepse nuk ka vlerësuar ofertat e dorëzuara sipas kriterëve për dënimin e kontratës -Oferta me cmimin më të ulët por ka shpallur fitues kompaninë pa asnjë bazë ligjore e cila nuk është e përgjegjshme sepse ka cmimin jashtë prashikimit të Kontrates dhe cmimin më të lartë se cmimi i Tregut.

Neni 60-Kriteriu për Dënimin e Kontrates

1. Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin me cmimin më të ulët;

Ky kriter është shkelur nga Autoriteti Kontraktues sepse ka shpallur fitues OE i cili ka ofertën më të shtrejtë se kompani tona dhe ka ofertën me cmim më të lartë se sa cmimi i parashikuar i kontratës dhe më i lartë se sa cmimi i tregut.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, **është i pabazuar**

KRPP si organ Rregullativ i Prokurimi Publik, ku AK dhe çdo palë tjetër mund të referohet

INTERPRETIMIT Numër 38, të datës: 26.12.2024, të nxjerr nga KRPP, ku thotë:

38. 26.12.2024 A mund AK ta përfundoj një aktivitet të prokurimit në rastet kur ka tejkalim të vlerës së parashikuar?

Konform nenit 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, sa i përket çështjes së Përfundimit të Aktivitetit të Prokurimit, KRPP sqaron si në vijim:

Përfundimi i një aktiviteti të Prokurimit rregullohet me Nenin 62 të LPP-së.

Paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 i neni 62 të LPP-së përcakton:

"2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

"2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit"

Gjithashtu, neni 4 përkatësisht paragrafi 4.1 pika a, b dhe c të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, përcakton si në vijim:

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive

b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, me vet faktin që paragrafi 2 i nenit 62 të LPP-së i lartë cituar përmend fjalën mund dhe jo kushtimisht duhet (të përfundoj aktivitetin e prokurimit) Autoriteti Kontraktues nuk është i obliguar ta anuloj një aktivitet të prokurimit edhe pse të gjithë tenderuesit kanë ofruar çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për atë aktivitet të prokurimit.

Pra, kurdo që Autoriteti Kontraktues sigurohet se çmimet e ofruara në ofertën më të lirë janë çmime reale të tregut si dhe mund të siguroj mjete shtesë me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA, për atë aktivitet të prokurimit, mund të vazhdojë me procedurë të më tutjeshme.

Ne si AK: Komuna e Rahovecit, ne bazë të Interpretimit të KRPP-së si më lartë, kemi kërkuar sqarime nga Njësia Kërkuese:

Te nderuar,

Po ju informojmë lidhur me tenderin me titull: **Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026**, Nr. i Prokurimit: **623-25-3824-1-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-25-035-1-2-1**, ku gjatë Urdhëresës për shpallje të këtij tenderi, vlera e parashikuar ka qenë: **92,160.00 Euro**;

Hapja e tenderit ka qenë me date: **27.05.2025**, ku kemi pranuar **Gjashtë (6) Oferta**;

Oferta e parë dhe e dytë me çmim më të ulët, **është e papërgjegjshme** ne bazë kriterëve të vendosura ne Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit!

Oferta e përgjegjshme me çmim më të lirë, është në vlerë prej: **105,600.00 Euro**;

Procedura e prokurimit është Kontratë Kornizë, ku Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është: +30%

Ju lutem na tregoni se ju si Njësi Kërkuese a keni mjete financiare për mbulesën e këtij projekti

Sa i përket ofertave të tenderuesve që ofrojnë çmim mbi vlerën e parashikuar të kontratës, Paragrafi 1 si dhe paragrafi 2.1 i neni 62 të LPP-ës përcaktojnë si në vijim:

*Autoritetet kontraktuese **mund** të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:*

"të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit"

Me vet faktin që paragrafi i latë cituar përmend fjalën **mund** dhe jo kushtimisht **duhet** (ta anulohet aktivitetin e prokurimit) Autoriteti Kontraktues nuk është i obliguar ta anulohet një aktivitet të prokurimit edhe pse të gjithë tenderuesit kanë ofruar çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për atë aktivitet të prokurimit.

Pra në qoftë se Autoriteti Kontraktues konstaton se çmimet e ofruara në ofertë janë çmime reale të tregut si dhe mund të sigurojë mjete shtesë, duke u siguruar me dëshmi me shkrim për atë aktivitet të prokurimit, AK nuk është i obliguar ta anulohet aktivitetin në fjalë, por mund të vazhdojë me procedurë të mëtejshme.

Dhe ne si Zyra e Prokurimit kemi marrë **aprovim nga Njësia Kërkuese** ku ka mjete shtesë për mbulesën për këtë kontratë, po ashtu **Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve**, e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, me datë: **11.06.2025**, si Dokument Shtojcë, ku tek **Neni 3: SHQYRTIMI i Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve**, është e Nënshkruar nga ZKF dhe ZKA, për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu ne si AK: Komuna e Rahovecit, gjatë fazës së vlerësimit kemi analizuar çmimin e ofruar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ku çmimi i ofruar është çmimi real dhe i tregut.

Po ashtu këto janë çmimet nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit:

Shih tabelën e Ofertave të dorëzuar me çmim:

Nr.	Titulli	Njësia matëse	Sasia e Përafërt e Planifikuar	Çmimi për njësi (Tone)	Totali
1	Furnizim me Pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026	Tone	384.00		-
Çmimet e Ofruara nga Operator Ekonomik					
			384.00	299.00	114,816.00
			384.00	289.00	110,976.00
			384.00	299.00	114,816.00
			384.00	275.00	105,600.00

Andaj Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Neni 28 Specifikimet teknike :Jemi eliminuar pa te drejt nga AK sepse ne ditën e Ofertimit ne kur e kemi pru me dorëzuar mostrën sipas kërkesë se AK-se kemi ardhur me 4 mostra te cilat kemi dashtur ti dorëzojmë 4 lloje te Peletit dhe AK te vendos se cilen vendos qe te vashoj tutje por personi pergjegje i cili i ka pmaur mostrat i ka thene personit te autorizar te kompanise tone qe ju lutem ta leni kete moster sepse kjo i ploteson kriteret tona dhe pastaj eshte lene vetem nje moster e thesit te pelti dhe ne momentin e dorzimi perfaqesuae i kompanise fituese gjate gjithë kohes ka ndejtur ne zyret e Komunes se rahovecit dhe ne si kompani dyshojem se mostra e OE Fitues eshte nryshuar pas dorzimit te ofertave dhe se jane kordinuar se bashku me zyrtare tuaj prandaj mendojme se jane bere shkelje te mjaftueshem ne bashkpunim ndermjet stafit te juaj dhe OE Fitues dhe kerkojme edhe nga ju por do te kerkojme edhe nga organet Kompetente qe te shikohet edhe inqizimet ne dite e dorzimit te ofertave dhe mostrave nga operatorët Ekonomike. Sa i perket Specifikimeve mendojme se Peleti jone i ploteson te gjitha kushtet e kerkuar dhe keni mundur per pikat qe dyshoni te kerkoni sqarime shtese dhe ne ti drejtohem pruidhuesit per sqarime me te detajuara.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, **është i pabazuar**

Në pretendimin tuaj keni cekur: *Jemi eliminuar pa te drejt nga AK sepse ne ditën e*

Ofertimit ne kur e kemi pru me dorëzuar mostrën sipas kërkesë se AK-se kemi ardhur me 4 mostra te cilat kemi dashtur ti dorëzojmë 4 lloje te Peletit

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, nga Dëshmia e Kërkuar dokumentare kemi kërkuar: Dëshmia 3: Mostrat e kërkuara tek specifikat teknike të mbyllura **në një paketim dalluese** të Operatorit Ekonomik

Në pretendimin tuaj keni cekur: dhe AK te vendos se cilën vendos qe te vashoj tutje por personi pergjegje i cili i ka prnaur mostrat i ka thene personit te autorizar te kompanisë tone qe ju lutem ta leni ketë mostër sepse kjo i plotëson kriteret tona dhe pastaj është lënë vetëm një mostër e thesit te pelti

Pretendimi juaj është i pabazuar dhe i pavërtetë, pasi që te procesverballi i dorëzimit të Mostrave është i njëjti kod sikurse tek banderola e thasit

Shih foton:

REGJISTRI I MOSTRAVE TE DORËZUAR NGA OPERATOR EKONOMIK							
Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:		623-25-3824-1-2-1 623-25-035-1-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru		Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2025/2026		
Nr.1 Br.	Tenderuesi ² Tenderer Name Tenderer	Vendi	Pranimi i tenderit / Tender Reception / Prijem tendera				Nënshkrimi i dorëzuesit të tenderit Tender Deliverer's Signature Potpis dostavljača tendera
			Data Date Datum	Ora Time Čas	Zyrtari / Officer / Službenik		
					Emri / Name / Ime	Nënshkrimi / Signature/ Potpis	
1	3824-2025	—	27. 05 2025	11:30	TEKI MUSTAFA		044-168-622 
2	3900225590010	—	27. 05 2025	11:58	— / —		044-333-324 
3							
4							
5							
6							
7							



Në pretendimin tuaj keni cekur: se mostra e OE Fitues eshte nryshuar pas dorzimit te ofertave dhe se jane kordinuar se bashku me zyrtare tuaj prandaj mendojme se jane bere shkelje te mjaftueshem ne bashkpunim ndermjet stafit te juaj dhe OE Fitues dhe kerkojme edhe nga ju por do te kerkojme edhe nga organet Kompetente qe te shikohet edhe inqizimet ne dite e dorzimit te ofertave dhe mostrave nga operatorët Ekonomike.

Pretendimi juaj është i pabazuar dhe i pavërtetë

Po ashtu në pretendimin tuaj keni cekur: Sa i perket Specifikimeve mendojme se Peleti jone i ploteson te gjitha kushtet e kerkuar dhe keni mundur per pikat qe dyshoni te kerkoni sqarime shtese dhe ne ti drejtohem proidhuesit per sqarime me te detajuara.

Neve si AK, nuk na lejohet te kërkojmë sqarimet shtesë, pasi që Nenit 72, paragrafi 3. thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Andaj Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>